



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. 2-D/DPK	Nr. Prot. Br. Prot. 01-195/15
Nr. i faq. Broj stranica 02	Data Datum 26-01-2015
Nr. pages	Date
PRISHTINË	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 22.01.2015, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK- 03-4704/14, për, ish zyrtarin e lartë z. Muhamed Krasniqin, Kordinatorë-Këshilltar politik ne zyrën e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, për shkak se është shmangur gjendja e mundshme të konfliktit të interesit, pasi qe zyrtarit i ka mbaruar mandati.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të mundshëm të interesit me numër protokolli AKK-03-4704/14, qe për trajtim ka pasur zyrtarin z. Muhamed Krasniqi, Koordinatorë - Këshilltar politik ne zyrën e Kryeministrit të Republikës së Kosovës

Gjatë zhvillimit të procedurës dhe analizimit të gjendjes është konstatuar se zyrtari z. Muhamed Krasnqi, gjatë kohës se ushtrimit të funksionit publik si zyrtar i lartë, kordinator-këshilltar politik ne ZKM, është i angazhuar ne veprimtari private si pronar dhe person i autorizuar, ne një biznes privat e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L- 051, kjo situatë paraqet konflikt të mundshëm të interesit, dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin te funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit me datën 15.12.2014. e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet qe posedon Agjencia.

Zyrtari i lartë z. Krasniqi ka ardhur ne AKK, me datën 23.12.2014 ku është njoftuar nga zyrtarët e AKK-së, për faktet qe disponon Agjencia lidhur me dyshimin për Konflikt të mundshëm të interesit, gjatë takimit të mbajtur z. Krasniqi është pajtuar me gjendjen, por na ka njoftuar se i ka mbaruar mandati si zyrtar i lartë, dhe nuk do ta ushtron me funksionin qe ka pas.

Pas këtij takimi me datën 08.01.2015, kemi marr njoftimin zyrtar nga zyra e personelit të zyrës se Kryeministrit ku na njoftojnë se z.Muhamed Krasniqi, Kordinatorë - Këshilltar politik në ZKM, i ka përfunduar mandati.

Vlerësojmë se pasi ka përfunduar mandatin si zyrtar i lart, dhe pas rrethanave te krijuara konsiderojmë se është shmangur gjendjen e mundshme e konfliktit të interesit për zyrtarin, z. Muhamed Krasniqi, andaj u vendos si ne dispozitiv te këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

